

KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Subjekti konsiderohet se përmbush kriterin e përshtatshmërisë për të kryer veprimtarinë profesionale me përmbushjen e kritereve teknike dhe profesionale.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, të lëshuar nga Administrata Tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Vlera e fondit limit është referuar preventivit të projektit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi për përvojën e mëparshme, duhet të paraqiten, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Dëshmitë dhe vërtetimet e kërkuara do të plotësohen sipas shtojcës 9 shoqëruar me kontratë, situacione dhe akt-kolaudimi.

2.3.2 Mbi licencat profesionale

2.3.2.1 Subjektet zbatuese, pjesëmarrëse në konkurim duhet të zotërojnë, Licenca profesionale të Zbatimit, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.012008, , “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”:

- N.P-4 – A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale;

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet licenca profesionale.

Licencat duhet të jenë të paraqitura dhe të plotësohen nga licenca e subjektit si dhe të gjitha pikat e sipërpërmendura të cilat jepen edhe për individë duhet të përmbushen nga shumtorja e pikave të licencave individuale të stafit inxhinierik i cili në rastin e shpalljes fitues së shoqërisë do të jetë stafi inxhinierik i realizimit të punimeve.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të Republikës së Shqipërisë.

2.3.2.2 Subjektet pjesëmarrëse kërkohen të zotërojnë, Licenca ne Projektim, referuar Vendimit nr. 943, Date 28. 12. 2016, për “Licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”:

- Kat 6. Projektues rrugë – hekurudha:
Pika. b. Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

Individët apo personat juridik të cilët disponojnë licenca të cilat nuk janë në përputhje me pikat e Lidhjes 2 “Kategorite në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, të V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre. Në rastin e mosparaqitjes së licencave, ofertuesit nuk do të merren në konsideratë për kualifikim.

Duhet të dorëzohet licenca në projektim e shoqërisë si dhe licenca individuale e drejtuesit teknik me pikat përkatëse.

2.3.6 Mbi certifikimet e kompanisë

- Shoqëria duhet te paraqesë Certificate te cilesise ISO 9001:2018 ose ekuivalente (e vlefshme).
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë ISO 45001:2018 ose ekuivalente (e vlefshme).

Shënim: Çertifikatat e mësipërme/ekuivalentet duhet të jenë të lëshuara nga Institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojnë këto certifikata.

5 Përcaktime të tjera

Në këtë kontratë prokurimi nuk do të lejohen nënkontraktimet krahas nënkontraktimit vetëm për projektin. Në këtë rast nënkontraktimi do të deklarohet që në fillim të procedurës dhe duhet të dorëzohet dokumentacioni i nënkontraktorit.